# UNIVERSITETI I PRISHTINËS
## Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit - Pejë

| PLANPROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Niveli i studimeve*** | BACHELOR | ***Departamenti*** | MTH | ***Viti akademik*** | 2010/2011 | | |
| **LËNDA** | **MAKROEKONOMI** | | | | | | |
| ***Viti*** | I | ***Statusi i lëndës*** | E obliguar | ***Kodi*** | 3112 | ***ECTS kredi*** | 8 |
| ***Semestri*** | 2 | | | | | | |
| ***Javët mësimore*** | 15 | ***Orët mësimore*** | Ligjerata | Ushtrime | | | |
| | | | 4 | 1 | | | |
| ***Metodologjia e mësimit*** | Ligjerata, ushtrime, punime seminarike, konsultime, teste, raste studimi, detyra | | | | | | |
| ***Konsultime*** | Një orë para dhe një orë pas ligjëratave | | | | | | |
| ***Mësimdhënësi*** | **Msc.Ariana Xhemajli** | e-mail | **arianaxhemajli@gmail.com** | | | | |
| | | tel. | **045 304 604** | | | | |
| ***Asistenti*** | **Msc.Ariana Xhemajli** | e-mail | **arianaxhemajli@gmail.com** | | | | |
| | | tel. | **045 304 604** | | | | |

| **Qëllimi studimor dhe përmbajtja e lëndës** | **Përfitimet e studentit** |
|---|---|
| Ky kurs ka për qëllim tu ofrojë studentëve konceptet kryesore lidhur me funksionimin e ekonomisë nacionale dhe ndërkombëtare dhe politikave ekonomike në zbatim. Në pjesën e partë trajtohen çështjet bazike të makroekonomisë si: kërkesa agregate, oferta agregate, investimet, bruto produkti vendor (GDP) si dhe agregatët e tjerë makroekonomikë. Trajtimi i këtyre temave mundëson që në pjesën e dytë të kursit të diskutohen çështjet që kanë të bëjnë me inflacionin, papunësinë, rritjen ekonomike, funksionimin e sistemit bankar dhe lidhjet ekonomike ndërkombëtare Në këtë kurs trajtohen edhe politikat dhe instrumentet e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. | Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje që:<br>1. Të formojnë opinionin e tyre në lidhje me situatën ekonomike në vend dhe problemet e rritjes ekonomike duke përdorur treguesit makroekonomik të shpjeguar gjatë këtij kursi,<br>2. Të vlerësojnë efektin e politikave fiskale dhe monetare në agregatët kryesorë makroekonomik në kontekst të situatave të caktuara,<br>3. Të vlerësojnë efektet e lidhjeve ndërkombëtare në ekonominë e vendit,<br>4. Të prezantojnë në forme grafike dhe përmes modeleve të thjeshta matematikore opinionet e tyre mbi problemet/situatat ekonomike. |

**Metodologjia për realizimin e temave mësimore:**

Çdo javë mbahen nga 4 orë ligjërata dhe 1 orë ushtrime. Pas çdo ligjërate jepen detyra për përgatitjen e eseve, të cilat diskutohen në javën në vijim. Studentët inkurajohen që të përcjellin rrjedhat ekonomike në vend, gazetat, revistat dhe internetin dhe të nxjerrin tema për diskutim. Esetë e përgatitura lidhur me këto çështje merren parasysh në vlerësim. Mësimdhënia do të përqendrohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e mësimit, me prezantime individuale e grupore, me komente mbi ligjëratën/prezantimin e mësimdhënësit etj.

**Kushtet për realizimin e temës mësimore**:

- Salla e pajisur me kompjuter dhe projektor

**Mënyra e vlerësimit të studentit ( në %):**

Në mënyrë që të ketë një vlerësim sa më të drejtë të punës së studentëve, nota përfundimtare është rezultat i aktivitetit të studentëve të treguar gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, dy vlerësimeve gjatë semestrit dhe një provimi përfundimtar. Vlera e secilës nga këto do të jetë si vijon:

- Vlerësimi i parë: 20%
- Vlerësimi i dytë 20%

| **Vlerësimi në %** | **Nota përfundimtare** |
|---|---|
| 91-100 | 10 (dhjetë) |
| 81-90 | 9 (nëntë) |
| 71-80 | 8 (tetë) |
| 61-70 | 7 (shtatë) |
| 51-60 | 6 (gjashtë) |

| | | |
|---|---|---|
| - Seminaret 10% *(shpjegimet shtesë)*<br>- Provimi final 50 %<br>Total 100%<br><br>Gjatë vlerësimit do të merren parasysh, përveç tjerash, edhe këto aspekte:<br>- interpretimi i temës,<br>- thellësia e të kuptuarit të temës,<br>- shfrytëzimi i literaturës,<br>- evaluimi dhe sinteza e evidencës,<br>- analizat kritike dhe<br>- logjika e ndërtimit të argumentit.<br><br>Përveç kësaj, vëmendje në vlerësim do tu kushtohet edhe:<br>- drejtshkrimit,<br>- prezantimit vizual të të dhënave dhe referencave,<br>- gjatësisë së shkrimit dhe<br>- prezantimit të përgjithshëm. | 0-50 | 5 (pesë) |

**Obligimet e studentit:**

| Ligjërata | Ushtrime |
|---|---|
| • Vijimi i ligjëratave<br>• Pjesëmarrja aktive në diskutime gjatë ligjëratave<br>• Punimi seminarik<br>• Pjesëmarrja në teste<br>• Provimi përfundimtar | • Pjesëmarrja në ushtrime<br>• Puna grupore në raste studimi dhe detyra<br>• Pjesëmarrja në diskutime lidhur me rastet e studimit |

**Ngarkesa e studentit për lëndën**

| Aktiviteti | Orë | Ditë/Javë | Gjithsejtë |
|---|---|---|---|
| Ligjerata | **4** | **15** | **60** |
| Ushtrime | **2** | **15** | **30** |
| Punë praktike | **1** | **15** | **15** |
| Kontakte me mësimdhënësit/konsultimet | **1** | **15** | **15** |
| Ushtrime në terren | - | - | - |
| Kolokviume, seminare | **2** | **15** | **30** |
| Detyra të shtëpisë | - | - | - |
| Koha e studimit vetanak | **2** | **15** | **30** |
| Përgatitja përfundimtare për provim | **1** | **20** | **20** |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final, etj.) | **2** | **10** | **20** |
| Projektet, prezentimet, etj. | **2** | **10** | **20** |
| **Vërejtje:** 1 ECTS kredi = 30 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 6 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 180 orë | | **Ngarkesa totale:** | 240 |

| Java | Ligjerata | | Ushtrime | |
|---|---|---|---|---|
| | **Tema** | **Orët** | **Tema** | **Orët** |
| 1. | Tema: Hyrje në Makroekonomi – Ligjëratë hyrëse<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XIII<br>Sloman (2006), Kapitulli 13 | 4 | Tema: Hyrje në Makroekonomi – Ligjëratë hyrëse<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XIII<br>Sloman (2006), Kapitulli 13 | 1 |
| 2. | Tema: - Ekuilibri Makroekonomik<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XIV<br>Sloman (2006), Kapitujt 14.2, 15.2. 15.3, 15.4 | 4 | Tema: - Ekuilibri Makroekonomik<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XIV<br>Sloman (2006), Kapitujt 14.2, 15.2. 15.3, 15.4 | 1 |
| 3. | Tema: Konsumi dhe investimet<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XV<br>Sloman (2006), Kapitulli 16.1 | 4 | Tema: Konsumi dhe investimet<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XV<br>Sloman (2006), | 1 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Kapitulli 16.1 | |
| 4. | Tema: Shpenzimet dhe të ardhurat<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XVI | 4 | Tema: Shpenzimet dhe të ardhurat<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XVI | 1 |
| 5. | Tema: Diskutime dhe vlerësimi i parë intermediar<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapituljt XIII-XVI | 4 | Tema: Diskutime dhe vlerësimi i parë intermediar<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapituljt XIII-XVI | 1 |
| 6. | Tema: Ciklet e biznesit dhe rritja ekonomike<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XVII Sloman (2006), Kapitulljt 16.4, 17.3 | 4 | Tema: Ciklet e biznesit dhe rritja ekonomike<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XVII Sloman (2006), Kapitulljt 16.4, 17.3 | 1 |
| 7. | Tema: Inflacioni<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XVIII Sloman (2006), Kapitulli 14.3 | 4 | Tema: Inflacioni<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XVIII Sloman (2006), Kapitulli 14.3 | 1 |
| 8. | Tema: Papunësia<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XIX Sloman (2006), Kapitulli 14.1 | 4 | Tema: Papunësia<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XIX Sloman (2006), Kapitulli 14.1 | 1 |
| 9. | Tema: Raporti Inflacion Papunësi<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XX Sloman (2006), Kapitulli 14.5 | 4 | Tema: Raporti Inflacion Papunësi<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XX Sloman (2006), Kapitulli 14.5 | 1 |
| 10. | Tema: Diskutime dhe vlerësimi i parë intermediar<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapituljt XVII-XX | 4 | Tema: Diskutime dhe vlerësimi i parë intermediar<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapituljt XVII-XX | 1 |
| 11. | Tema: Paraja dhe sistemi banka<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XXI Sloman (2006), Kapitujt 17.1, 17.3 | 4 | Tema: Paraja dhe sistemi banka<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XXI Sloman (2006), Kapitujt 17.1, 17.3 | 1 |
| 12. | Tema: Banka qëndrore dhe politika monetara<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XXII Sloman (2006), Kapitulli 19.2 | 4 | Tema: Banka qëndrore dhe politika monetara<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XXII Sloman (2006), Kapitulli 19.2 | 1 |
| 13. | Tema: Politika fiskale<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XXIII Sloman (2006), Kapitulli 19.1 | 4 | Tema: Politika fiskale<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XXIII Sloman (2006), Kapitulli 19.1 | 1 |
| 14. | Tema: Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XXIV Sloman (2006), Kapitulli 23 | 4 | Tema: Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitulli XXIV Sloman (2006), Kapitulli 23 | 1 |
| 15. | Tema: Diskutime dhe vlerësimi i tretë intermediar<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitujt XXI-XXIV | 4 | Tema: Diskutime dhe vlerësimi i tretë intermediar<br>Literatura: Mançellari at al. (1999), Kapitujt XXI-XXIV | 1 |

**LITERATURA:**

**Literatura bazë:**
Mançellari, A., Hadëri, S., Kule, Dh. dhe Qirici, S. (1999): *Hyrje ne Ekonomi*. Shtëpia botuese Pegi, Tiranë.

**Literatura shtesë:**

1. Sloman, J. (2006). *Economics*. Prentice Hall.

2. Raportet e Bankës Qëndrore të Kosovës, Entit të Statistikave të Kosovës, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave,

Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar etj. që janë të bëjnë me temat që ligjërohen në këtë kurs (për secilën temë studentët do të udhëzohen se cilin raport të këtyre institucioneve duhet ta lexojnë).

**VËREJTJE:**

*Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentet inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime lidhur me to.*

**Vërejtje për studentin:**

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale. Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.